



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr. 555/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. nr. 555/2022, të datës 21.06.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

nga Komuna e Kaçanikut, kundër organit të punësimit Komuna e Kaçanikut, në çështjen juridike “ kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr. 555/2022, e datës 21.06.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 01Nr. 104/02-12168/2022 i datës 05.06.2022 i Udhëheqëses së Personelit të Komunës së Kaçanikut.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Kaçanikut dhe Udhëheqësi i Personelit, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke nxjerr vendim për njohjen e përvojës së punës për ankuesin në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi me datë 21.06.2022, me numër protokoll 3609/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Udhëheqësja e Personelit e Komunës së Kaçanikut, me datë 05.06.2022, me numër protokoll 01 Nr. 104/02-12168/2022, ka nxjerr vendim lidhur me përvojën e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.06.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Kaçanikut, Ndërsa me datë 13.07.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen ne ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritior ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 21.06.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 3609/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; formuari për kërkesë ose ankesë e datës 06.05.2022; Vendimi i datës 05.06.2022, i Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Kaçanikut; shkresë e datës 14.03.2015; Mirënjohje; Certifikatë e datës 19.02.2004; Deklarata ne betim e datës 03.06.2015; dehmi nga trusti prej datës 23.07.2004, deri me datë 28.04.2022;Dëshmi nga banka për periudhën 01.01.2002, deri me datën 31.12.2004; Vërtetim i datës 02.07.2015;Akt Emërimi i datës 31.10.2012; Vendim i datës 03.07.2015; Vendim i datës 05.06.2022; certifikatë e datës 29.07.2018; Përgjigje në ankesë e datës 13.07.2022, me numër protokoll 4070/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit te të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi më datë 05.05.2022 ka paraqitur kërkesën tek Komuna e Kaçanikut, lidhur me njohjen e përvojës së punës në organizatat ndërkombëtare përkatësisht në Fondacionin Amerikan të Veteranëve të Vietnamit VVAF për periudhën 01.05.2022 deri më datë 01.05.2022. Njësia e Personelit e Komunës së Kaçanikut më datë 05.06.2022 ka nxjerr Vendim me numër 01Nr. 104/02-12168/2022 me të cilin nuk i ka njohur këtë përvojë të punës për faktin që nuk ka ofruar dokumentacionin e kërkuar sipas Qarkores së Ministrisë së Administratës Publike të datës 14.05.2015.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që komuna në mënyrë të padrejtë nuk i ka njohur përvojën e punës në këtë organizatë.





Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat përkatëse në fuqi që rregullojnë këtë çështje dhe në bazë të dokumentacionit të ofruar, konstaton se ankuesi ka dorëzuar Mirënjohjen e lëshuar nga VVAF, Certifikatën për 27-30.05.2002 të lëshuar nga VVAF, Certifikatën e datës 19.02.2004 të lëshuar nga VVAF, Referencën e lëshuar nga VVAF, Deklaratën nën betim e datës 03.06.2015 më të cilën ka deklaruar që ka qenë i angazhuar nga Fondacionin Amerikan të Veteranëve të Vietnamit VVAF për periudhën 01.05.2002 deri më datë 01.05.2004, dhe Pasqyrën e Trustit Pensional, me të cilën ka paguar kontributet për periudhën shtator 2003, dhjetor 2003 dhe mars 2004, dhe listën e pagesave në Procredit Bank nga muaji korrik 2002 deri në muajin korrik 2004.

Bazuar në Qarkoren e Ministrisë së Administratës Publike me Nr. 2489 të datës 14.05.2015 të dërguar për Ministritë, Kryetarët e Komunave, Udhëheqësit e Organizatave Buxhetore të Republikës së Kosovës dhe Udhëheqësit e Organizatave të Sektorit Publik, në pikën 1 përcaktohet që: *“Njohja e përvojës së punës pas Qershori 1999 dëshmohet përmes njërit nga këto dëshmi: 1.5. dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga Organizatat Qeveritare dhe Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare të shoqëruara me dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale ose dëshmi mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent dhe 1.7. Si dëshmi tjetër plotësuese mund të konsiderohet edhe lista e pagave”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këtë dhe duke i'u referuar dëshmive të ofruara nga ankuesi, vlerëson që ankuesi posedon referencën që ka qenë i angazhuar në Fondacionin Amerikan të Veteranëve të Vietnamit VVAF, duke poseduar edhe dëshmi nga lista e pagave përmes Procredit Bank dhe po ashtu posedon pasqyrën e llogarinë nga Trusti ku vërtetohen se ka kontribuar në kontributet pensionale në shtator 2003, dhjetor 2003 dhe mars 2004, ndërsa në bazë të emailit të datës 14.08.2015 përcaktohet që: *“Në llogarinë e juaj online në të cilën figuron kolona Periudha në atë kolonë janë periudhat apo muajt për të cilat punëdhënësi dhe ju keni ndarë kontribute pensionale, kurse në kolonën e parë e cila është Data e Transaksionit, në atë kolonë janë datat kur kanë ardhë shënimet për ju. Në rastin tënd ju keni filluar të ndani kontribute në 09/2003, pra figuron 12/2003 dhe 03/2004, që do të thotë se janë raporte tremujore”*, si rrjedhojë ankuesi ka plotësuar kushtet që t'i njihet periudha e përvojës së punës për kohën e pretenduar sepse i njëjti ka edhe deklaratën nën betim të nënshkruar nga ankuesi dhe dy persona të tjerë, dhe mbi këtë bazë Kolegji, konstaton se janë plotësuar kushtet sipas Qarkores së Ministrisë së Administratës Publike me Nr. 2489 të datës 14.05.2015, kështu që Vendimi me numër 01Nr. 104/02-12168/2022 i datës 05.06.2022 i Udhëheqëses së Personelit të Komunës së Kaçanikut, sa i përket kësaj çështje nuk është nxjerr në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, ndërsa pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Kaçanikut është i obliguar të nxjerr vendim për njohjen e përvojës së punës për ankuesin në pajtim me këtë vendim dhe dokumentet e prezantuara.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr. 555/2022

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Eshref SHABANI



Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kaçanikut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kaçanikut;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

